



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 08.12.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 17.12.2021, **SHPALLË:**

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar për zbatueshmërinë e kontratave në Departamentin e Financave- një (1) vend pune:

II. Numri i referencës: NPL –D.M. 17/12/2021;

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të veprojnë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të ndërmarrjes në fuqi.
- T'i trajtojnë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës. Nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- Të përcjell, ritmin e pagesave mujore të lokaleve afariste dhe evinenteve kulturore e sportive dhe të njoftoj eprorët, nëse ka ngecje të pagesave, dhe të propozoj të ndërmerren masa ligjore ndaj tyre.
- Të bashkëpunoj me departamentet përkatëse dhe me zyrtarin për klient, në lidhje me rendin shtëpiak.
- Do të monitoron nënshkruesit e kontratave, nëse të njëjtit nuk i përmbahen dispozitave të kontratës, dhe të njëjtëve duhet ti dërgoj vërejtje me shkrim.
- Do të punon edhe punë tjera sipas urdhëresës së eprorit

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni); Dëshmi për shkollimin e noterizuar; përvoja e punës e vërtetuar me këto dokumente të protokolluara nga punëdhënësit ku ka punuar: vërtetimi nga punëdhënësit, kontrata e punës nga punëdhënësit ku ka punuar, si dhe referenca e punës nga punëdhënësit, kopja e trustit pensional, Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera; Kopja e letërnjoftimit; Certifikata e lindjes; Adresa e vendbanimit; Nr. i telefonit kontaktues si dhe E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Kualifikimi i mesëm – drejtimi ekonomik i noterizuar,- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;- Njohuria obligative e kompjuterit.- Përvoja e punës, e dëshirueshme, - Njohja e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Office).- Të ketë aftësi komunikuese dhe të jetë në gjendje të punojë i pavarur dhe në ekupe, të jetë fleksibil në ndryshime dhe orar si dhe ti përballojë punën nën presion.

VI. Kohëzgjatja e emërimit;

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit;

- Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data 17.12.2021.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim;

- Aplikacionet për punësim mund të merren në ueb faqën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe fizikisht në zyrën e Departamentit të Administratës dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim;

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.